

RAPORT ALTERNATIV PËR GJENDJEN ME TË DREJTAT E FËMIJËVE NË MAQEDONI – NGA KËNDVËSHTRIMI I FËMIJËVE

Ambasada e Parë e Fëmijëve në
Botë - Megjashi
– Republika e Maqedonisë



RAPORT ALTERNATIV PËR GJENDJEN ME TË DREJTAT E FËMIJËVE NË MAQEDONI

– NGA KËNDVËSHTRIMI I FËMIJËVE

Shkup, nëntori 2020

Titulli

Raport alternativ për gjendjen me të drejtat e fëmijëve në Maqedoni – nga këndvështrimi i fëmijëve

Botues

Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë – Megjashi, Republika e Maqedonisë

Rr. Kosta Novakoviç 22a, 1000 Shkup

<http://www.childresembassy.org.mk/>

02 2465 316 SOS telefon për fëmijë dhe të rijnë 070 390 632

Mbi botuesin

m-r Dragi Zmijanac, kryetar dhe themelues

Autorë

Aleksandar Stojanovski (14), Antonija Teovska (12), Evgenija Xhabirska (13), Edina Miftaroska (12), Erza Capa (12), Julita Postolova (17), Klara Kostadinovska (13), Magdalena Petrovska (13), Matea Eftimovska (12), Mia Xhambas (14), Monika Jordanovska (16), Sara Duka (14) dhe Teuta Ziberi (17)

Mentore

Jordanka Çerepnalkova –Trajkoska dhe Vaska Bojaxhi

Përkthim në gjuhën shqipe

Eniena Aeti

Ilustrimi i ballinës

Monika Jordanovska (16)

Ilustrimi i faqeve të brendshme

Evgenija Xhabirska (13), Eda Marke (14), Edina Miftarska (12), Darija Guberiniç (8), Erza Capa (12), Julita Postolova (17), Klara Kostadinovska (13), Magdalena Petrovska (13), Mia Xhambas (14), Monika Jordanovska (16), Sara Abdushi (14), Sara Duka (14) dhe Sude Hasani (13).

Ky raport është mbështetur financiarisht nga Qeveria e Suedisë. Autorët kanë përgjegjësi të plotë për përmbajtjen. Qeveria Suedeze nuk duhet doemos të ndajë pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në raport.

PËRMBAJTJA

PARAFJALA	4
HYRJE	7
TEMA 1: NJOHJA ME TË DREJTAT E FËMIJËS DHE RESPEKTIMI I TYRE	10
TEMA 2: DHUNA MBI FËMIJËT	16
2.1 DHUNA BASHKËMOSHATARE.....	16
2.2 DHUNA PSIKOLOGJIKE.....	17
2.4 PEDOFILIA.....	20
TEMA 3: DISKRIMINIMI.....	24
3.1 DISKRIMINIMI NË BAZË TË PAMJES FIZIKE	25
3.2 DISKRIMINIMI NË BAZË TË PÛRKATËSISË ETNIKE.....	26
3.3 DISKRIMINIM NË BAZË TË GJUHËS	27
3.4 DISKRIMINIMI NË BAZË TË PÛRKATËSISË EKONOMIKE	27
3.5 DISKRIMINIMI GJINOR.....	28
TEMA 4: KOHA E LIRË, LOJA, AKTIVITETET SPORTIVE DHE KULTURORE.....	32
4.1 KOHA E LIRË	32
4.2 AKTIVITETET SPORTIVE.....	34
4.3 AKTIVITETE KULTURORE, ARTISTIKE DHE TË TJERA	36
TEMA 5: FËMIJËT E RRUGËS.....	38
TEMA 6: ARSIMI	42
TEMA 7: MJEDISI JETËSOR	54

PARAFJALA

Raporti para jush është puna e një ekipi fëmijësh, të moshës 12 deri 17 vjeç, të cilët pranuan ftesën e Ambasadës së Parë të Fëmijëve në Botë - Megjashi për të marrë pjesë në procesin e përgatitjes së raportit. Këta nxënës dhe shkollat e tyre ishin pjesë e aktiviteteve të Ambasadës së Fëmijëve - Megjashi në kuadër të projekteve "Le të marrim të drejtat në duart tona", "Forcimi i aftësive të fëmijëve për parandalim të dhunës" dhe Programit të Edukimit për Paqen, përmes të cilit ata fituan njohuri kryesore për të drejtat e fëmijëve

Procesi i përgatitjes së raportit u organizua në dy faza: faza e hulumtimit dhe faza e shkrimit të raportit. Gjatë fazës së hulumtimit (maj-korrik 2020), u hartua dhe u zhvillua një pyetësor mbi situatën e të drejtave të fëmijëve, i cili siguroi të dhëna gjithëpërfshirëse për disa aspekte të jetës së fëmijëve në vend, problemet me të cilat përballen fëmijët dhe gjërat të cilat ata mendojnë se duhen përmirësuar. Pyetësori u shpërnda në internet në maqedonisht dhe shqip, dhe u plotësua nga 1,077 fëmijë në të gjithë vendin, të moshës 12 deri në 17 vjeç. Gjithsej tridhjetë nxënës nga 11 shkolla fillore dhe të mesme në Veles¹, Vinicë², Gostivar³, Dibër⁴ dhe Shkup⁵ morën pjesë në hartimin, pilotimin dhe implementimin e pyetësorit. Trembëdhjetë nxënës nga ky grup vendosën të përfshihen në fazën tjetër - duke shkruar raportin. Më shumë informacion në lidhje me hulumtimin mund të gjeni [këtu](#).

Në fazën e dytë të procesit (korrik-tetor 2020), u mbajtën online takime dhe punëtori të vazhdueshme me fëmijët, në mënyrë që të përmirësohen njohuritë e tyre mbi Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe procesin e raportimit para Komitetit të KB për të Drejtat e Fëmijëve. Shumica e takimeve ishin mbi

¹ ShMK "Koço Racin" dhe ShMPK "Dimitrie Çupovski" ShMPK "Dimitrija Çupovski"

² ShMK "Vanço Prke" dhe ShFK "Slavčo Stojmenski"

³ ShMK "Gostivar" dhe ShMEK "Gostivar"

⁴ ShMK "28 Noevmri" dhe ShFK "Said Najdeni"

⁵ ShMQSh "Nikola Karev", ShMQSh "Zef Lush Marku" dhe ShFK "Stiv Naumov"

përgatitjen e raportit, duke përfshirë përzgjedhjen e temave, ndarjen e detyrave për shkrim midis fëmijëve, redaktimin e teksteve dhe hartimin e raportit. Fëmijët përgatitën raportin duke reflektuar në gjetjet e hulumtimit mbi gjendjen e të drejtave të fëmijëve, por gjithashtu bazuar në përvojën e tyre personale dhe të bashkëmoshatarëve të tyre.

Përvoja që ekipi i Ambasadës së Fëmijëve Megjashi e fitoi me mentorimin e këtij grupi nxënësish është e paçmuar; jo vetëm për punën tonë si avokatë për të drejtat e fëmijëve, por edhe më shumë, për angazhimin dhe zbatimin tonë të parimit të pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset e vendimmarrjes për gjëra të rëndësishme për ta.

Ky raport përmban njohuri të hollësishme dhe të thelluara të fëmijëve në situatën me të drejtat e fëmijëve në vend dhe rekomandime të sakta për tejkalimin e problemeve dhe mangësive. Prandaj, vlerësojmë se këtë raport duhet doemos ta lexoj secili që interesohet për mirëqenien e fëmijëve dhe promovimin e të drejtave të tyre.

Jordanka Çerepnalkova-Trajkovska dhe Vaska Bojaxhi

Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë – Megjashi

13 tetor 2020, Shkup

HYRJE

Autore: Magdalena Petrovska dhe Julita Postolova

Përshëndetje, ne jemi fëmijët nga ekipi i Ambasadës së Fëmijëve Megjashi dhe si pjesëmarrës në këtë projekt për të drejtat e fëmijëve, si dhe me zbatimin e pyetësorit kemi fituar shumë njohuri të reja, përvoja të reja dhe miqësi të reja.

Para kësaj pandemie globale, ne fëmijët së bashku me ekipin e Ambasadës së Fëmijëve Megjashi qëndronim në qytete të ndryshme, ku kishim punëtori për të kuptuar më mirë të drejtat e fëmijëve.

Duhet të pranojmë që ne vetëm pjesërisht dinim për të drejtat e fëmijëve dhe gjithashtu kuptuam se ata shpesh shkelen me ose pa vetëdije. Por edhe gjatë pandemisë, ne fëmijët me ekipin e Megjashit vazhduam të krijojmë kontakte nëpërmjet online takimeve në platformën Zum. Kemi marrë pjesë në mënyrë aktive në hulumtimin për situatën me të drejtat e fëmijëve në Maqedoni duke realizuar një pyetësor për të drejtat e fëmijëve.

Pyetësori u zhvillua online, në periudhën nga 1 qershor deri më 5 korrik 2020. Temat vijuese u përfshinë në pyetësor:

- NJOHJA ME TË DREJTAT E FËMIJËS DHE RESPEKTIMI I TYRE
- MJEDISI SHKOLLOR
- KOHA E LIRË
- SHËNDETI DHE CILËSIA E JETËS
- MJEDISI JETËSOR
- SIGURIA
- DISKRIMINIMI

Pyetësori u plotësua nga 1077 fëmijë, nga i gjithë vendi, nga të cilët 60.26% janë vajza dhe 38.94% djem (0.78% e fëmijëve nuk ofruan të dhëna të vlefshme për gjininë e tyre).

85% e të anketuarve janë maqedonas, ndërsa përqindja tjetër janë nga pakicat. Kufiri i moshës së fëmijëve që morën pjesë në hulumtim ishte nga 12 në 17 vjeç. Sa i përket vendbanimit, 63% të fëmijëve jetojnë në qytet, 37% në fshat, 43% shkojnë në shkollë fillore dhe 57% janë në shkollë të mesme.


Ky raport është përgatitur nga ne fëmijët, sepse kemi dashur të informojmë Komitetin e KB për të Drejtat e Fëmijëve mbi situatën me të drejtat tona në Maqedoni dhe nga këndvështrimi ynë të bëjmë rekomandime për përmirësimin e situatës me të drejtat e fëmijëve.

Raporti që vijon bazohet kryesisht në të dhënat nga pyetësi, por edhe nga vëzhgimet tona shtesë.



TEMA 1

NJOHJA ME TË DREJTAT E FËMIJËS DHE RESPEKTIMI I TYRE



TEMA 1: NJOHJA ME TË DREJTAT E FËMIJËS DHE RESPEKTIMI I TYRE

Autore: Teuta Ziberi dhe Erza Capa

Të drejtat e fëmijëve janë të drejta brenda të drejtave të njeriut, me theks të veçantë në të drejtat e mbrojtjes dhe kujdes të veçantë për të miturit. Konventa për të Drejtat e Fëmijëve e përcakton fëmijën si "Çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, përveç nëse, sipas ligjit në fuqi, ai ose ajo arrin pjekurinë më herët."


Fëmijët dhe të rinjtë kanë të njëjtat të drejta të përgjithshme të njeriut si të rriturit, si dhe të drejta specifike që i njohin nevojat e tyre të veçanta. Fëmijët nuk janë as pronë e prindërve të tyre dhe as pronë e pafuqishme e bamirësive. Ato janë qenie njerëzore dhe u nënshtrohen të drejtave të tyre.

Të drejtat e fëmijëve përfshijnë të drejtën e tyre për familje dhe prindër, identitetin, si dhe nevojat themelore për mbrojtje fizike, ushqim, arsimim universal, kujdes shëndetësor dhe ligje penale të përshtatshme për moshën dhe zhvillimin e fëmijës, mbrojtje të barabartë të të drejtave civile dhe lirisë së fëmijës nga diskriminimi i bazuar në racë, seks, orientim seksual të fëmijës, identitet gjinor, origjinë kombëtare, fe, paaftësi, ngjyrë, përkatësi etnike ose karakteristika tjera.

Sa të njohur janë fëmijët me të drejtat e tyre?

Sipas hulumtimit, pjesa më e madhe e fëmijëve (62.8%) kanë dëgjuar për Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, por vetëm një pjesë shumë e vogël (2.85%) e kanë lexuar atë. 1/3 e fëmijëve nuk kanë dëgjuar kurrë për Konventën për të Drejtat e Fëmijëve.

Më shumë se gjysma e fëmijëve (56.4%) mendojnë se janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre, dhe më së shpeshti ata janë të informuar për të drejtat e tyre në shkollë (92.33%), në internet (55.83%) ose në shtëpitë e tyre (51,91%).




Sa respektohen të drejtat e fëmijëve?

Hulumtimet kanë treguar që të drejtat e fëmijëve respektohen në përgjithësi, megjithëse jo në nivelin e duhur. Të drejtat e fëmijëve janë të drejtat e qenieve njerëzore dhe si të tilla nuk duhet të lihen vetëm në letër.

A mendon se njerëzit rreth teje i respektojnë të drejtat e fëmijëve?			
	Po, tërësisht i respektojnë të gjitha të drejtat, gjithmonë	Pjesërisht i respektojnë (disa të drejta i respektojnë, disa jo)	Aspak nuk i respektojnë
Në shtëpi	56.84%	41.51%	1.64%
Në shkollë	37.32%	59.67%	3.01%
Në vendbanimin tënd	28.19%	67.43%	4.38%

Sipas deklaratave të fëmijëve mund të konkludojmë se më së shumti nuk respektohen:

E drejta e arsimimit



E drejta e lojës

“Kur fëmijët luajnë në rrugë, të rriturit i qortojnë mos të bërtasin dhe i përzënë nga rruga. Ua mohojnë të drejtën e lojës.”

E drejta e mjedisit jetësor të pastër

“E drejta më e shkelur e fëmijëve në vendbanimin tim është e drejta për ajër të pastër.”

E drejta për mendim të vet dhe të shprehurit

“Kur fëmija nuk është i aftë vet të shpreh se çfarë është e mirë dhe e rëndësishme për të, prindi është personi përgjegjës për fëmijën, por prindi nuk e pyet fëmijën dhe vendos vet për të.”

“Për shembull në situatë ku fëmijës i “urdhërohet” të hesht pasi mendimi i tij/saj vlerësohet si mendim i fëmijës.”

“Shumë herë në shkollë ndodh që mos të dëgjohet mendimi ynë deri në fund. Këto ngjarje zakonisht shoqërohen me frazën: “Keni edhe shumë të kaloni”. Ne se jemi fëmijë nuk domethënë se nuk kemi qëndrimin tonë, secili ndërton karakterin e vet dhe ka mendimin e vet. Ndoshta jo secili pajtohet me mendimet tona, por vlerësoj se duhet të na dëgjojnë.”

Trajtim i pabarabartë për shkak të përkatësisë së tyre etnike dhe fetare

“Kur nxënësit përqeshin nxënës tjetër/tjerë për shkak të përkatësisë racore ose fetare ose ju drejtohen me fjalë fyese.”

“Kur fëmijët janë të refuzuar në disa raste për shkak të kombësisë ose fesë së tyre, kur për shkaqet e njëjta institucionet shtetërore refuzojnë t’ju ofrojnë ndihmë.”



TEMA 2

DHUNA MBI FËMIJËT



Draw some kidss
life...



and draw some other
kids life...





TEMA 2: DHUNA MBI FËMIJËT

Autorë: Evgenija Xhabirska, Monika Jordanovska, Aleksandar Stojanovski, Julita Postolova, Teuta Ziberi, Mia Xhambas, Erza Capa, Klara Kostadinovska dhe Magdalena Petrovska

Ekzistojnë më shumë lloje të dhunës ku fëmijët mund të jenë viktimë, duke përfshirë ngacmimin fizik, psikologjik, seksual, ekonomik, familjar, me bazë gjinore, nga bashkëmoshatarët dhe sajber dhunën.

Sipas hulumtimit tonë, 10% e fëmijëve ndonjëherë kanë qenë viktimë të dhunës, dhe më shumë se 20% njohin dikë që ka qenë viktimë e dhunës. 13% e fëmijëve deklarojnë se janë gjetur në situatë për të lënduar dikë, kryesisht në vetëmbrojtje ose në mbrojtje të një shoku, si dhe kur kanë qenë nervozë ose të zemëruar dhe nuk kanë ditur se si të kontrollojnë ndjenjat e tyre, dhe ju ka ndodhur që pa dashje të lëndojnë dikë verbalisht.





2.1 DHUNA BASHKËMOSHATARE

Fëmijët janë më shpesh viktimë të dhunës nga bashkëmoshatarët. Dhuna nga bashkëmoshatarët nuk është një incident i vetëm që nuk do të përsëritet, një zënkë miqësore ose mosmarrëveshje, shkaktim i paqëllimtë i dhimbjes ose një ngacmim miqësor. Bëhet fjalë për një formë të sjelljes agresive që zgjat kohë të gjatë, pra

kur nxënësi vazhdimisht dhe shpesh është i ekspozuar ndaj veprimeve negative nga një ose më shumë nxënës, të cilët qëllimisht duan ta lëndojnë, ta poshtërojnë ose ta tallin.

Disa shembuj se si disa fëmijë e shohin dhunën e bashkëmoshatarëve:




Rekomandime:

Rekomandimi ynë për të parandaluar dhunën nga bashkëmoshatarët është se **NUK DUHET TË JEMI VËZHgues PASIVË**. Nëse jemi dëshmitarë të atij lloji të dhunës nga bashkëmoshatarët, duhet menjëherë të marrim masa dhe të reagojmë. Informoni shërbimet e shkollës, si dhe prindërit e fëmijëve. Nëse thjesht vëzhgojmë dhe nuk reagojmë, kjo do të thotë që edhe ne jemi bashkëpunëtorë. Ne fëmijët, kërkojmë përfshirje më aktive të mësuesve dhe shërbimeve të tjera në shkollë. Përveç mësimdhënies së përmbajtjes, mësuesit duhet të kenë edhe biseda joformale me nxënësit në mënyrë që të zbulojnë dhe parandalojnë çdo dhunë nga bashkëmoshatarët. Prindërit gjithashtu duhet t'i kushtojnë vëmendje gjatë edukimit të fëmijëve të tyre, se si ata do të sillen jashtë dhe në shkollë.

2.2 DHUNA PSIKOLOGJIKE

Gjithçka që përfshin poshtërim, kërcënim, fyerje, dhe ngjashëm llogaritet si dhunë që lë pasoja, disa prej të cilave janë vetëvlerësimi i zvogëluar, ankthi, depresioni, mungesa e dëshirës për të shkuar në shkollë,

tërheqja dhe vetë-lëndimi. Nga shembujt e dhënë nga fëmijët në hulumtim, rezulton se ndonjëherë dhuna psikologjike mund të kryhet nga fëmijët, por nganjëherë vjen edhe nga mësuesit ose anëtarët e familjes.



Rekomandime:

- Një pjesë e arsimit t'i kushtohet kundër ngacimit nga bashkëmoshatarët dhe si të ballafaqohen me të.
- Të ketë njerëz të punësuar që do të kenë një zonë të caktuar (shkolla, rrugë, etj.) ku do të ecin dhe kujdesen që të mos ndodhë asnjë dhunë, nëse kjo ndodh, ngacmuesit duhet t'i sigurohet një psikolog cilësor (të punësohen psikologë cilësorë) ku ai do të shkojë në seanca derisa të largohet çdo traumë që e bën atë të kryejë dhunë.
- Të mbahen punëtori për mësime për sjelljen e duhur me fëmijët, dhe nëse ata nuk e respektojnë atë sjellje, të merren masa ndaj mësimeve.
- Të ketë punëtori/trajtime ku do të ligjërohet për dashuri dhe empati mes vete.



2.3 SAJBER DHUNA

Në epokën e teknologjisë së përparuar, ngacmimi i të miturve ose bashkëmoshatarëve nëpërmjet internetit është bërë i zakonshëm. Ky lloj dhune njihet si ngacmim në internet (sajber-dhuna) dhe mund të përfshijë ngacmime, keqinterpretime, ndarjen e informacionit personal të dikujt tjetër dhe veprime të ngjashme në internet.

Keqtrajtohen shokët/shoqet e klasës që dikujt nuk i pëlqen të jenë në të njëjtën shoqëri. Fëmijët e besimeve të tjera dhe fëmijët që janë në gjendje të pafavorshme financiare abuzohen gjithashtu. Edhe fëmijët që mësojnë shumë dhe janë të tërhequr janë abuzuar, d.m.th. fëmijë që kanë sukses më të mirë në shkollë. Pra, viktimat të sajber-dhunës ose ngacmimit në internet mund të jenë të gjithë anëtarët e shoqërisë tonë. Ky lloj i dhunës është shumë i rrezikshëm sepse përcjell përmbajtje që dikush dëshiron të shpërndajë dhe të lëndojë dikë tjetër. Kjo përcjellje e shpejtë e këtyre materialeve përfshin gjithashtu një gamë të gjerë, d.m.th. shumë persona mund ta shohin dhe vazhdojnë veprimin në një periudhë të shkurtër kohe, pa ditur prapavijën e dhunës. Ajo përhapet shpejt dhe lehtë sepse institucionet kompetente nuk ndërmarrin masat dhe sanksionet e duhura kundër ngacmimit në internet. Ngacmimi në internet është zakonisht anonim ose i rremë dhe shkakton shqetësim, poshtërim, pikëllim, brengosje dhe mllef për viktimat e ngacmimit në internet.

Fatkeqësisht, shumica e viktimave të ngacmimit në internet, kur zbulojnë se janë abuzuar virtualisht dhe se janë viktimat të ngacmimit në internet, tërhiqen dhe bien në depresion. Ata zakonisht nuk dinë të thonë se janë abuzuar virtualisht sepse kanë turp. Por ka viktimat që mund të përballen dhe t'i tregojnë familjes, shkollës, policisë, miqve ose bashkisë dhe të zgjidhin problemin. Fatkeqësisht, numër i këtyre viktimave të ngacmimit në internet që mund të ballafaqohen është shumë i vogël.

Në hulumtimin tonë, pothuajse 1/4 e fëmijëve deklarojnë se njohin bashkëmoshatar/e, të dhënat, fotot ose videot e të cilit/ës janë shpërndarë në internet pa pëlqimin e tij/saj, ndërsa gati se 8% prej tyre ju ka ndodhur personalisht. Nëse dikush i ngacmon ata në Internet ose abuzon me të dhënat e tyre personale, shumica e

fëmijëve do të drejtohen te familja e tyre dhe policia, ndërsa pothuajse 1/3 do t'i drejtohen Agjencisë për Mbrojtje të të Dhënave Personale.

Rekomandime për fëmijët:

Mos lejoni që të jeni viktimë e ngacmimit në internet (sajber-dhunës). Mos u dekurajoni dhe mos u tërhiqni. Drejtoheni diku ku mendoni se do të jeni të sigurt, sepse tani, në këtë botë "të re" dhe në këtë brez "të ri" një konflikt i vogël mund të shkakton dhunë, ngacmim, nënçmim, trishtim, probleme dhe shqetësime. Për të shmangur të qenit viktimë e ngacmimit në internet, mos ndani kurrë informacionin tuaj personal në internet, mos i tregoni fjalëkalimit askujt përveç prindërve tuaj, nëse dikush ju dërgon mesazh ngacmues mos u përgjigjuni, tregojeni atë një të rrituri tek i cili keni besim, mos dërgoni kurrë mesazhe dikujt që nuk e njihni, mos dërgoni mesazhe nëse jeni inatosur me dikë, sepse atëherë do të pendoheni, etj. por MBANI NË MEND se ndoshta ne fëmijët dimë më shumë për teknologjinë dhe botën virtuale, por të rriturit dinë shumë më tepër për jetën reale.



2.4 PEDOFILIA

Pedofilia është abuzimi seksual i fëmijëve. Kjo lloj dhune në Maqedoni shfaqet gjithnjë e më shpesh, por numri i saj kurrsesi nuk zvogëlohet.

Të gjithë mund të jemi viktimë të pedofilisë, pavarësisht nga gjinia, mosha, përkatësia etnike dhe vendbanimi. Por viktimat më të zakonshme të pedofilisë janë vajzat e reja që hyjnë në pubertetet ose janë tashmë në të, por në disa raste ato janë shumë më të vogla. Pedofilia nuk domethënë se kryhet nga një i rritur i panjohur në rrugë, ajo më së shpeshti kryhet nga të afërmit tanë, siç janë anëtarët e familjes, miqtë, fqinjët, të njohurit dhe shumë të tjerë.

Nëse një vajzë është viktimë e pedofilisë ndonjëherë, ajo do të mbingarkohet me paragjykime nga rrethina e saj dhe do të fajësohet për një ngjarje të tillë, pa u pyetur se si ka ndodhur. Të gjithë do ta dënojnë me

fjalitë "e ke lypë" ose " duhet të ketë qenë e dehur, andaj ka lejuar që të ndodh ajo gjë". Në raste të tilla prindërit duhet të jenë mbështetja më e madhe për fëmijën dhe ta inkurajojnë atë që pa marrë parasysh se çfarë, jete vazhdon, dhe se ata do të jenë gjithmonë mbështetja e saj më e madhe, gjithashtu do ta inkurajojnë duke i thënë se gjëra të tilla ndodhin shpesh dhe se ajo nuk është fajtoare.

Rekomandime:

Një prej rekomandimeve tona për të mbrojtur veten nga kjo lloj dhune duhet të jetë edukimi i duhur, duke treguar se si fëmijët të mbrohen dhe të veprojnë nëse janë viktimë të këtij lloji të dhunës. Fëmijët e kopshteve duhet të edukohen për seksualitetin e tyre, si të mbrohen nga pedofilia dhe çfarë të bëjnë nëse bëhen viktimë. Prindërit gjithashtu kanë nevojë për edukim, që të dinë se si t'i këshillojnë fëmijët e tyre për t'u mbrojtur dhe çfarë të bëjnë nëse fëmija i tyre është viktimë. Ne nuk kemi një edukim të tillë në Maqedoni, por nëse futet ndonjëherë, duhet të mësohet më shpesh, duke filluar nga kopshti deri në përfundimin e shkollës së mesme. Fëmija që i është nënshtruar kësaj lloj dhune duhet të vizitohet nga psikolog, që do ta ndihmojë atë të stabilizojë situatën dhe t'i japë këshilla të përshtatshme se si të pajtohet me një ngjarje të tillë dhe si të veprojë kur një i njohur gjithashtu do jetë viktimë e saj.


Gazetarët, nëse raportojnë ndonjëherë për pedofilët në lajme ose në internet platformat, në asnjë rast nuk duhet t'i japin të dhënat personale të personit që është viktimë e dhunës. E njëjta gjë vlen për prindërit, ata nuk duhet të tregojnë që fëmija i tyre ka qenë viktimë e pedofilisë vetëm në qoftë se fëmija pajtohet që ata të flasin për këtë.

Askush nuk duhet të jetë kurrë viktimë e kësaj lloj dhune, të gjithë duhet të mbrohemi nga ajo, sepse së bashku jemi më të fortë, gjithmonë është më mirë kur të gjithë jemi të bashkuar për të zgjidhur një problem ose kur bëhet fjalë për mbrojtjen e përbashkët.




TEMA 3

DISKRIMINIMI



No change can come if those who are impacted the most by discrimination are not willing to stand up for themselves.

Discrimination is a disease.




TEMA 3: DISKRIMINIMI

Autorë: Evgenija Xhabirska, Teuta Ziberi, Julita Postolska, Matea Eftimovska, Antonija Teovska, Edina Miftarovska, Klara Kostadinovska, Sara Duka dhe Magdalena Petrovska

Diskriminimi është çdo veprim që shkakton trajtim të pabarabartë që nuk është i bazuar në mënyrë legjitime dhe proporcionale, në një mënyrë ku një person apo grup i veçantë përjashtohet, kufizohet ose i jepet përparësi në gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore bazuar në disa karakteristika personale. Diskriminimi ndodh kur njerëzit trajtohen ndryshe vetëm në bazë të karakteristikave personale ose përkatësisë në një grup të veçantë. Ekzistojnë lloje të ndryshme të diskriminimit në të gjithë botën bazuar në: gjininë, seksin, gjuhën, racën, ngjyrën e lëkurës, etninë, shtetësinë, fenë, përkatësinë politike, shëndetin, moshën, arsimin, familjen dhe statusin martesor, statusin personal ose shoqëror, origjinën familjare, statusin pronësor, që i përkasin një grupi të marginalizuar.

Cilat janë arsyet më të zakonshme për diskriminimin e fëmijëve?

Sipas hulumtimit, 42.24% e fëmijëve janë ndjerë të diskriminuar në një situatë të caktuar, kryesisht për shkak të moshës, gjinisë, statusit financiar të familjes së tyre, etnisë. Fëmijët thonë se diskriminohen gjithashtu për shkak të pamjes, peshës dhe ngjyrës së lëkurës, si dhe vendbanimit, stilit të veshjes ose muzikës që dëgjojnë.




Në një rast të caktuar, më shumë se 1/3 e fëmijëve kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit, nga të cilët 34.26% thanë se kundërshtuan personin që i ka diskriminuar, ose vetëm e kanë raportuar tek një i rritur. 6% e fëmijëve zbulojnë se ata kanë diskriminuar dikë.

Diskriminimi është i rrezikshëm sepse prodhon qasje dhe gëzim të pabarabartë të të drejtave të njeriut dhe lirive të fëmijëve. Çdokush mund të jetë viktimë e diskriminimit, njëlloj si kushdo mund të jetë diskriminues i mundshëm, ndërsa diskriminimi mund të ndodhë në çdo sferë të jetës, d.m.th. në shoqëri.

3.1 DISKRIMINIMI NË BAZË TË PAMJES FIZIKE

Diskriminimi në bazë të pamjes fizike është ndarja e personave që janë të ndryshëm nga të tjerët sipas pamjes së tyre, siç janë ngjyra e lëkurës, pesha, lartësia, mbajtja e syzeve, forma e veshit, stili i flokëve dhe veçori tjera.

Gjatë zhvillimit të hulumtimit, disa nga fëmijët e anketuar gjithashtu theksuan shembuj personalë të diskriminimit për shkak të karakteristikave fizike:



Ky lloj diskriminimi mund t'i lëndojë fëmijët emocionalisht dhe t'i detyrojë ata të bëjnë zgjedhje të gabuara dhe të lëndojnë veten. Askush nuk dëshiron të tallet dhe nënvlerësohet nga një grup i caktuar para miqve të tyre.

3.2 DISKRIMINIMI NË BAZË TË PËRKATËSISË ETNIKE

Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike është një formë serioze e diskriminimit dhe është shumë e zakonshme në shoqëri të ndryshme. Një shembull i këtij lloji të diskriminimit në shoqërinë tonë janë romët të cilët, si pakica më e prekshme, shpesh janë të izoluar shoqërisht, dhe ka paragjykime të shumta lidhur me ato. Popullsia rome ka qenë një shënjestër e nazistëve që nga Lufta e Dytë Botërore, me synimin për t'i shfarosur, por lufta e tyre kundër qëndrimeve diskriminuese të njerëzve dhe shoqërisë në tërësi vazhdon.

Që në moshë të re, qëndrimi diskriminues i institucioneve dhe njerëzve ndikon në zhvillimin e fëmijëve romë. Fëmijët romë shumë shpesh nuk e dinë gjuhën maqedonase, sepse janë të rrethuar vetëm me romë, kështu që kur shkojnë në shkollë kanë vështirësi në procesin arsimor. Popullata rome shpesh vuan nga sëmundje të ndryshme, qasja në kujdesin shëndetësor është e vështirë dhe ankesat për trajtimin diskriminues të romëve nga personeli mjekësor janë të zakonshme. Romët shpesh dëgjojnë komente raciste drejtuar atyre dhe kështu cenueshmëria e tyre si një komunitet etnik rritet.

Fëmijët nuk tregojnë mbi problemin me diskriminimin në mjedisin në të cilin lëvizin, derisa prindërit e tyre nuk janë të edukuar sa duhet për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.



3.3 DISKRIMINIM NË BAZË TË GJUHËS

Sipas të dhënave të hulumtimit, 11.27% e pjesëmarrësve deklaruan se kanë qenë të diskriminuar për shkak të gjuhës. Në pjesën lindore të vendit, popullsia turke dhe rome diskriminohet nga gjuha sepse shkojnë në shkollat maqedonase dhe gjuha e tyre nuk mësohet, janë të detyruar të mësojnë gjuhën maqedonase, ndërsa në pjesën perëndimore të vendit ky lloj diskriminimi ndodh mes nxënësve maqedonas dhe shqiptarë, ku nxënës të caktuar thjesht nuk duan të shoqërohen me njëri-tjetrin për shkak të gjuhës që flasin. Gjithashtu kemi shembullin e me fëmijët bashkëmoshatarë dhe mësuesit e tyre që flasin në dialekt. Por do të marrim edhe Suedinë si shembull, sepse atje, pavarësisht nga kombësia, ka kurse për çdo gjuhë amtare. Rekomandimi ynë për komunat është që të bëjnë kurse të njëjta për secilën gjuhë.



3.4 DISKRIMINIMI NË BAZË TË PËRKATËSISË EKONOMIKE

Gjendja e pasurisë, buxheti i familjes, gjendja ekonomike dhe financiare e familjes përcakton në masë të madhe se sa anëtarët e asaj familjeje do të jenë në gjendje të ushtrorë plotësisht të drejtat e tyre (arsimi, shëndeti, jeta kulturore, etj.), dhe shpesh janë viktimat të izolimit social. Një dukuri shumë e zakonshme në mesin e njerëzve është formimi i qëndrimeve të gabuara, paragjyqimeve ose stereotipave në lidhje me kategorinë e qytetarëve të varfër, gjë që gjithashtu tregon një shkallë të lartë të diskriminimit ekonomik ndaj këtyre njerëzve.

Diskriminimi ekonomik ndaj fëmijëve është i dukshëm në të gjitha sferat e jetës. Shumë fëmijë në Maqedoni, për shkak të statusit ekonomik të prindërve ose kujdestarëve të tyre, nuk kanë jetë më të mirë, si dhe qasje në arsim më cilësor, jetë kulturore, shëndetësi ... Disa fëmijë, përkundër intelektit dhe dëshirës së tyre për të zgjeruar njohuritë, nuk janë në gjendje të ndjekin kurse, ngjarje kulturore, etj., kështu që arsimimi i tyre të reduktohet në arsimin fillor. Dhe tani në kushtet e një pandemie, shumë fëmijë, për shkak të mungesës së mjeteve themelore të komunikimit, u privuan nga sistemi arsimor i sapo formuar, d.m.th. mësimi në distancë.

Në komunikimin e përditshëm midis fëmijëve, diskriminimi ekonomik është shumë i theksuar. Fëmijët me status më të ulët ekonomik janë viktime të përditshme të talljeve nga bashkëmoshatarët e tyre. Më shpesh, ata tallen dhe fyhen, për shkak të vendbanimit të tyre, për shkak të mënyrës së veshjes, d.m.th. për shkak të pamundësisë për të blerë rroba dhe këpucë markë, pajisje të shtrenjta shkollore, celular të shtrenjtë etj. Për shkak të këtij qëndrimi ndaj fëmijëve me status më të ulët ekonomik, ata refuzohen nga bashkëmoshatarët e tyre dhe shpesh janë të izoluar shoqërisht.

Konkludojmë se në ditët e sotme qëllimi themelor i mjeteve financiare është keqkuptuar. Gjegjësisht, në vend që të jenë një mjet për të mundësuar një jetë normale, sot financat janë një tregues i fuqisë, autoritetit dhe përfitimit. Kjo është arsyeja pse fëmijët e prindërve më të fuqishëm kanë drejtimin e gabuar në jetë, me tallje dhe diskriminim ndaj më të varfërve të tyre.


3.5 DISKRIMINIMI GJINOR

Diskriminimi gjinor ndodh kur një person trajtohet më pak favorshëm se të tjerët në bazë të gjinisë. Gjatë gjithë historisë së njerëzimit ka shembuj të shumtë të diskriminimit gjinor, i cili është më i theksuar ndaj grave, në krahasim me burrat. Edhe sot, kur ndërgjegjësimi i njerëzve është në një nivel më të lartë, jemi dëshmitarë të diskriminimit gjinor të përditshëm, kryesisht ndaj grave, por në një numër të vogël rastet ndaj burrave nuk përjashtohen.

Diskriminimi gjinor i fëmijëve, mbi të gjitha, është më i përhapur në zonat rurale dhe ato më pak të zhvilluara ekonomisht, si dhe brenda familjeve tradicionale dhe në familjet me status më të ulët ekonomik. Si me të rriturit, ashtu edhe me fëmijët, femrat, d.m.th. vajzat, janë më të prekura nga diskriminimi gjinor. Nga ana tjetër, diskriminimi gjinor është i pranishëm në komunikimin e përditshëm të fëmijëve, kryesisht për shkak të ndarjes së lojërave në "të djemve" ose "të vajzave", gjë që çon në distancë sociale midis vajzave dhe djemve.

Rekomandime:

- Urgjentisht nevojitet socializimi i grupeve të diskriminuara të fëmijëve, rrjetëzimi arsimor dhe shtëpiak si dhe integrimi i të gjithë fëmijëve.
- Organizimi i detyrueshëm i veprimeve anonime humanitare për fëmijët në rrezik financiar.
- Edukimi i detyrueshëm i të rriturve në lidhje me diskriminimin (veçanërisht ata që nuk e kanë përjetuar).
- Mësuesit mund të kenë ndikim të madh dhe rol domethënës, nëse angazhohen pa pushim në procesin e përfshirjes së barabartë në sistemin arsimor të të gjithë fëmijëve në mënyrë të barabartë. Kjo do mundet të realizohet nëse të gjithë përfshiheshin në çdo projekt.
- Edukimi i detyrueshëm i fëmijëve dhe të rriturve për rolin dhe rëndësinë e burimeve financiare në jetë. Është e nevojshme që të gjithë, pavarësisht nga fuqia financiare, të kuptojnë dhe pranojnë kornizën e vendosur nga jetesa normale, të flasin me njëri-tjetrin dhe të arsimojnë veten, të kuptojnë se çfarë lejohet dhe çfarë jo, dhe të dallojnë dhe ndajnë veset pozitive nga ato negative që i kanë pranë.
- Nevojitet promovimi i barazisë gjinore mes vajzave dhe djemve nga institucionet, nga lindja deri në adoleshencë brenda një shoqërie. Kjo vlen veçanërisht për zonat rurale dhe atyre më pak të zhvilluara ekonomikisht, ku zbatimi i aktiviteteve të ndryshme duhet të synojë ndërgjegjësim në lidhje me diskriminimin gjinor.
- Futja e menjëhershme e lëndës Etikë në të gjithë procesin arsimor, dhe jo vetëm në një departament të caktuar.



TEMA 4

KOHA E LIRË, LOJA, AKTIVITETET SPORTIVE DHE KULTURORE




TEMA 4: KOHA E LIRË, LOJA, AKTIVITETET SPORTIVE DHE KULTURORE

Autore: Monika Jordanovska, Erza Capa, Antonija Teovska, Edina Mifatorska, Sara Duka


Loja dhe koha e lirë e fëmijëve nuk janë vetëm një domosdoshmëri, por edhe një e drejtë e qenësishme e çdo fëmije. Loja e fëmijëve është thelbësore në zhvillimin e aftësive sociale, emocionale dhe fizike të fëmijës. Koha e lirë në asnjë mënyrë nuk do të thotë humbje e kohës, përkundrazi, është një kohë që ia kushtojmë vetes, një kohë në të cilën plotësojmë nevojat tona, siç janë nevoja për lojë, argëtim, pushim dhe me rritjen dhe zhvillimin e potencialeve kështu përmirësohemi dhe bëhemi ato që jemi. Prindërit dhe kujdestarët duhet të respektojnë këto të drejta të fëmijëve.

4.1 KOHA E LIRË

Sipas të dhënave të hulumtimit, gjysma e nxënësve mendojnë se gjithmonë kanë kohë të mjaftueshme për aktivitetet që u pëlqen. Sidoqoftë, shumica (64.07%) deklarojnë se koha e tyre e lirë është e kufizuar për shkak të detyrave të shumta të shtëpisë dhe përgjegjësive tjera shkollore. Tabela më poshtë ilustron arsyet e fëmijëve për kufizimin e kohës së tyre të lirë.



Për shumicën e fëmijëve, surfimi në internet, përfshirë përdorimin e rrjeteve sociale dhe lojërat kompjuterike, janë mënyra e tyre e preferuar për të kaluar kohën e lirë. Nuk ka nevojë të ndalohen këto aktivitete, por duhet të jenë të kufizuara në kohë dhe të mbikëqyren.



Rekomandime për prindërit:

Prindërit duhet të përdorin kohën e tyre të lirë për biseda cilësore dhe të sinqerta me fëmijën e tyre (kur e marrin nga kopshti, kur bëjnë pazar së bashku, derisa ngasin veturën), që të merren vesh për kohën që mund ta kalojnë së bashku atë ditë dhe të dëgjojnë kujdes se çfarë fëmija ka për të thënë. Thelbi i kalimit të kohës së lirë cilësore me fëmijën tuaj nuk është sasia, por mënyra se si ata do ta kalojnë kohën. Fëmijët më të mëdhenj zakonisht kalojnë kohën e tyre të lirë me bashkëmoshatarët e tyre, jashtë shtëpisë, me shokët/shoqet me të cilët kanë interesa të përbashkëta, por edhe këtu roli i prindit dhe institucioneve është vendimtar në dhënien e drejtimit të duhur fëmijës.

Mos harroni, për ju prindërit loja është vetëm një lojë, por për ne është një medium nëpërmjet të cilit njohim veten dhe botën!

4.2 AKTIVITETET SPORTIVE


Sporti ka ndikim shumë të rëndësishëm në shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve duke ndihmuar zhvillimin e tyre mendor dhe fizik. Sporti ka ndikim tek fëmijët në disa aspekte dhe atë:

- rrit shoqërizimin tek fëmijët dhe inkurajon punën në grupe
- argëton fëmijët
- i mëson fëmijët të vendosin qëllime
- i mëson ata se si të merren me problemet dhe si t'i tejkalojnë ato

Edhe pse aktivitetet sportive kanë ndikim pozitiv në jetën e fëmijëve, ekzistojnë disa pengesa që i mbajnë fëmijët larg sporteve. Siç janë kushtet e këqija ekonomike në zonat rurale ku nuk ka palestera apo pajisje sportive, por edhe çmimet e larta për pjesëmarrje dhe regjistrim në klube sportive. Si rezultat, në vendin tonë, pjesëmarrja në aktivitete sportive është një privilegj vetëm për një kategori të caktuar të fëmijëve.

Mungesa e fushave sportive është e dukshme në zonat urbane, dhe në qytetet ku ka burime natyrore për zhvillimin e sporteve dhe aktiviteteve sportive, nuk përdoren.

Sondazhi tregon se 50.09% e fëmijëve thanë se ka mjaft klube për aktivitete sportive. Fëmijët përmendin disa pengesa që i pengojnë të marrin pjesë në sporte:




Rekomandime për autoritetet kompetente:

- Të ndërtohen fusha sportive ose terrene lojërash për fëmijët në zonat rurale me qëllim që fëmijët të kalojnë kohën e tyre të lirë duke luajtur sporte.
- Komunat duhet të jenë të interesuara të mbulojnë plotësisht ose pjesërisht kostot materiale për pjesëmarrjen e fëmijëve në aktivitete sportive.

4.3 AKTIVITETE KULTURORE, ARTISTIKE DHE TË TJERA

Aktivitete kulturore, artistike dhe aktivitetet tjera të tilla janë të rëndësishme për çdo fëmijë, sepse ia mundësojnë atij të gjejë veten, të mësojë më shumë për botën përreth tij, të ndihet i pranuar, i lirë, këto aktivitete janë të mira për shëndetin emocional, mendor dhe fizik.

Sipas hulumtimit, përqindja e fëmijëve që marrin pjesë në ngjarje kulturore është shumë e vogël (rreth 15%). Fëmijët theksojnë se duhet të organizohen më shumë aktivitete kulturore, artistike, sportive dhe të tjera.



Rekomandime:

- Një herë në javë të organizohen aktivitete të ndryshme (kulturore, sportive, artistike, etj.) ku fëmijët mund të shoqërohen, të argëtohen. Këto aktivitete duhet të jenë falas ose me çmime shumë më të ultë që çdo fëmijë të ketë mundësi ti ndjek. Kjo duhet të mundësohet në zonat rurale të paktën një herë në muaj.
- Një herë në dy muaj të pyesin fëmijët se çfarë ngjarjesh dëshirojnë të organizohen.



TEMA 5

FËMIJËT E RRUGËS



Klara Kostadinovska
Magdalena Petrovska

TEMA 5: FËMIJËT E RRUGËS

Autore: Evgenija Xhabirska, Julia Postolova dhe Matea Eftimovska

Me fëmijët e rrugës nënkuptojmë fëmijë që janë pa kujdes të duhur shoqëror, ekonomik dhe shëndetësor, fëmijë pa identitet dhe pa kushte normale të jetesës. Këtyre fëmijëve u janë kufizuar të drejtat themelore të njeriut, ata nuk shkojnë në shkollë, nuk kanë kohë të lirë dhe lojë, nuk mund të mjekohen kur janë të sëmurë, nuk kanë dashuri prindërore. Pamja është shqetësuese, veçanërisht në qytetet më të mëdha, ku këta fëmijë janë në çdo hap, në çdo moment dhe rreth çdo ngjarjeje. Ata lëndohen nga prindërit e tyre të cilët së bashku me ta janë pjesë integrale e rrugëve, të ngacmuar dhe poshtëruar, të diskriminuar dhe të shantazhuar. Këta fëmijë zakonisht vijnë nga familje të mëdha, të cilët ose janë arratisur nga diku ose nuk kanë arritur atje ku duhet, kështu që nuk kanë shtëpinë e tyre. Disa fëmijë në rrugë përdoren nga prindërit ose kujdestarët e tyre, duke i detyruar fëmijët të lypin në rrugë dhe duke i përdorur paratë që fëmijët i fitojnë për nevojat e tyre. Nëse fëmijët përpiqen të shpenzojnë një pjesë të fitimeve të tyre, mund të abuzohen fizikisht nga prindërit ose kujdestarët e tyre. Këta fëmijë kanë nevojë për më shumë vëmendje dhe kujdes.

Shumica e këtyre fëmijëve nuk kanë identitetin e tyre (nuk janë të regjistruar në librin amë të lindjeve, nuk kanë NUAQ), nuk kanë kushte themelore të jetesës, nuk janë të socializuar dhe nuk pranohen aspak nga mjedisi. Ata kurrë nuk fitojnë të drejtën për të qenë nxënës, janë analfabetë dhe nuk i dinë as të drejtat e tyre, as detyrimet e tyre. Këta fëmijë refuzojnë të bashkëpunojnë me institucionet kompetente dhe refuzojnë dorën e ndihmës nga të rrallët që e ofrojnë. Institucionet përgjegjëse për fantazmat e tilla dhe fëmijët e rrugës, kryesisht nuk dëshirojnë dhe nuk kanë kapacitete të marrin përsipër raste të tilla, hedhin përgjegjësinë prej njërit në institucionin tjetër, kurse problemi rritet, fëmijët shumohen, dhe banorët tjerë jetojnë me frikë.

Rekomandime:



Që të mbrojmë fëmijët nga përjetimi i traumave që kalojnë në rrugë, duhet të fitojnë kujdesin e shërbimeve sociale, të cilët do të kujdesen për fëmijët dhe më vonë do t'i dërgojnë në shtëpinë e fëmijëve ku do t'ju sigurohet arsimimi, kujdesi i duhur dhe dashuria e duhur që ata të rriten në njerëz të mirë. Gjithashtu nëse kanë prindër abuzivë, prindërit duhet të privohen nga shikimi i fëmijës së tyre dhe mos të jenë më prindërit e ligjshëm të fëmijës.

Kjo do të zvogëlojë numrin e fëmijëve që jetojnë në rrugë, rrugët do të jenë më të sigurta dhe vetë fëmijët do të kenë një jetë më të qetë dhe të sigurt.



TEMA 6

ARSIMI





TEMA 6: ARSIMI

Autorë: Monika Jordanovska, Aleksandar Stojanovski, Sara Duka, Mia Xhambas dhe Matea Eftimovska


Arsimi luan një rol të madh në jetën e fëmijëve, ata janë në shkollë gjysmën e ditës, dhe pastaj shkojnë në shtëpi dhe përgatiten për në shkollë. Gjysma e edukimit vjen nga shtëpia, dhe gjysma nga shkolla, që është si një shtëpi e dytë për fëmijët sot. Prandaj, ne duhet të përpiqemi ta bëjmë edukimin sa më cilësor që e ardhmja e njerëzimit të jetë e sigurt, nëse sigurojmë edukim me dashuri, pastërti, lumturi, paqe, respekt për të gjithë dhe me të gjitha rekomandimet e dhëna më poshtë, mund të jemi të sigurt se fëmijët do të jetë në gjendje të ndërtojë dhe të bëhen individë të plotë dhe të pavarur në një shoqëri.

1. CILËSIA E ARSIMIT

Nuk është e rëndësishme vetëm të ekziston mundësia për të shkuar në shkollë, por edhe ajo që mësohet atje dhe si atmosfera në të. Duhet të jemi të shëndetshëm fizikisht, emocionalisht dhe psikologjikisht që të jemi të plotë. Shkollat janë të detyruara të na edukojnë për secilën nga këto pjesë dhe ne presim që shkollat të kujdesen për ato. Gjithashtu, shkolla duhet të përgatisë fëmijët për pavarësi, duhet të pajisen me zgjidhje për problemet e jetës së përditshme, e jo shkolla të krijojë probleme psikologjike për ta.

A është ajo që mësohet në shkollë interesante dhe e dobishme?

Më shumë se 1/3 e fëmijëve pajtohen plotësisht se ajo që mësojnë në klasë është interesante për ta, dhe më shumë se 1/2 se është e dobishme dhe do t'i ndihmojë në të ardhmen.




Duke ndërtuar shkolla të ndryshme profesionale dhe duke pasur lëndë që do të nevojiten vetëm për atë profesion, fëmijët do të jenë në gjendje të zgjedhin drejtimin e dëshiruar dhe kështu të shijojnë më shumë orën shkollore.

Duhet të ketë gjithashtu edukim mbi tema që prekin disa fusha të jetës së përditshme të një individi. Për shembull, disa nga pjesëmarrësit në hulumtim e kanë theksuar këtë dhe një nga fëmijët e ka shprehur kështu:

“Fëmijët nuk janë të arsimuar sa duhet për seksin, orientimin seksual, marrëdhëniet që ndërtojmë, etj.”

Çfarë i bën fëmijët të ndihen mirë në shkollë?

Është pozitive që shumica e fëmijëve ndiejnë se i përkasin shkollës së tyre.



Fëmijëve u pëlqen të jenë të sigurt, të respektohen të drejtat e tyre, të mësojnë diçka interesante dhe të dobishme për jetën e përditshme, pëlqejnë aktivitete jashtëshkollore që i lejojnë ata të bëjnë atë që duan, higjienën, personelin dhe nxënësit.

“Unë mësoj atë që më intereson, disa nga mësuesit na mësojnë shumë gjëra që nuk kanë të bëjnë me shkollën, ka miqësi”.

“Ndhem i/e mbushur me energji pozitive”.

Çfarë do të donin të ndryshonin fëmijët në shkollat e tyre?

Ajo që fëmijët mendojnë se duhet të ndryshohet janë mosrespektimi, karriget dhe tavolinat e prishura, të ndërtohen rampa për fëmijë me karrocë dhe palestra në vende ku nuk ka, higjiena, qasjet stresuese të arsimtarëve, të shtohen më shumë aktivitete jashtëshkollore. Këto janë disa nga përgjigjet e fëmijëve në pyetjet "Çfarë mendoni se duhet të ndryshojë në shkollën tuaj?":

“Disa mësues, qasja e tyre dhe presioni mbi fëmijët që notat na ndërtojnë si njerëz dhe stresi që ata krijojnë.”


“Më shumë të dëgjojnë nxënësit për disa nga problemet e tyre.”

“Duhet të ketë instrumente në kabinetin për edukim muzikor, ku nxënësit do të luajnë për argëtim dhe relaksim ...”


“Të përmirësohen kushtet për sport dhe aktivitete sportive dhe të merren më shumë kompjuterë.”

“Më shumë aktivitete jashtëshkollore”

Fëmijët gjithashtu kanë më shumë ide se çfarë do të përmirësonin nëse do të ishin drejtorë shkollash. Ato do:




Më shumë se 60% të fëmijëve mendojnë se kanë shumë përgjegjësi shkollore që kufizojnë rëndë kohën e tyre të lirë. Në disa nga sistemet më të mira arsimore në botë (si ai në Finlandë) fëmijët nuk janë nën presion, nuk kanë detyra shtëpie (ose nganjëherë thjesht shumë të shkurtra) dhe nuk kanë teste (ose disa të shkurtra) për të cilat nuk janë nën presion dhe nuk u jepet përparësi ndaj nxënësve. Koha e lirë është e rëndësishme për shëndetin fizik, psikologjik dhe emocional dhe çdo fëmijë ka të drejtën për të dhe e meriton atë!



A respektohen mendimet dhe interesat e nxënësve?

Të gjithë fëmijët kanë interesa të ndryshëm që kërkojnë respekt. Të jesh anëtar i një grupi të jep të drejtën të shprehësh mendim dhe të marrësh pjesë në marrjen e një vendimi të caktuar, kështu që mendimi i të gjithëve duhet të dëgjohet dhe të merret parasysh gjatë marrjes së vendimeve si në shtëpi ashtu edhe në mjedisin shkollor. Në këtë drejtim, sipas hulumtimit që kemi bërë, ne kemi të dhënat e mëposhtme:




Shumë nxënës e shohin vizitën te një psikolog/pedagog si diçka për të qenë i turpëruar OSE si diçka të keqe sepse ata dërgohen në shërbimin profesional vetëm nëse kanë ndonjë problem.

Por fëmijët e pranojnë që pedagogu dhe psikologu mund të luajnë rol shumë më të rëndësishëm se ky.

“Disa fëmijë me të vërtetë kanë nevojë për ndihmë por ose nuk e dinë se ku të drejtohen, ose kanë frikë t’i besojnë dikujt. Unë mendoj se çdo fëmijë duhet të shkojë te një psikolog të paktën një herë në javë.”

A mësojnë fëmijët sa duhet për mbrojtjen e mjedisit jetësor?

Në shumicën e shkollave, vetëdija mbi mjedisin jetësor është e ulët. Vetëm një herë në vit ka mbjellje të pemëve dhe pastrim të oborrit, dhe në disa shkolla, as aq shumë. Në disa shkolla nuk ka asnjë aksion për të mbledhur shishe plastike dhe bateri, dhe nuk ka asnjë kosh plehrash ku mund të zgjidhet riciklimi, por pavarësisht asaj që kemi, shumë fëmijë ende hedhin plehra ku të duan, përfshirë edhe në oborrin e shkollës.




Si është zhvilluar ecur procesi arsimor që nga fillimi i pandemisë me Covid-19?

Gjatë pandemisë, ky vit shkollor (2020/2021) filloi më vonë, pra më 01.10.2020. Shumë nxënës nuk kanë pajisje elektronike dhe nuk mund të ndjekin mësimet, dhe aktualisht nuk është bërë asgjë për këtë. Shkollave u është thënë që të gjenden, shkollat ua kanë thënë të njëjtën mesuesve, mesuesit nxënësve dhe nxënësit kanë mbetur të pafuqishëm ... Secila shkollë ndërmer mënyra të ndryshme (ose asnjë) për t'i mësuar nxënësit që nuk kanë pajisje: shtypen planet, fletët e punës, etj. në shkolla dhe më pas nxënësit



shkojnë në shkolla për t'i marrë ato dhe për të mësuar nëpërmjet tyre në mënyrë të pavarur; atyre u thuhet të ndjekin mësimet në TV (e cila është e gabuar sepse nxënësi mund të mos ketë TV); përkohësisht u jepen kompjuterë nga shkolla për t'u kthyer pas përfundimit të orëve në internet; sigurisht që nuk duhet të harrojmë se ka shumë nxënës për të cilët ende nuk është bërë asgjë...

Ndërsa, për nxënësit që filluan me orë në internet mund të themi se vitin e kaluar shkollor (për këtë vit ende nuk mund ta vlerësojmë sepse sapo kemi filluar) gjatë pandemisë, disa prej shkollave filluan t'u japin shumë përgjegjësi nxënësve, që nuk është në rregull pasi mësimi është online dhe nxënësit kalojnë shumë kohë në laptopët e tyre dhe pajisjet tjera elektronike. Nxënësit duan të kenë më pak detyra sepse nuk është e dobishme për shëndetin e tyre (**fizike** - shpina, sytë, kanë nevojë për lëvizje, të jenë në natyrë, etj., **mendërisht** dhe **emocionalisht** (mungesa e socializimit), ndihemi sikur mësuesit nuk kanë empati ndaj ne.



Rekomandime:

Për programin mësimor:

- Programet e mësuesve duhet të përgatiten në mënyrë që të jetë e mundur që një fëmijë të mësojë aq shumë në 9 muaj pa u ngarkuar dhe të vendosë vetëm shkollën si përparësi. Nxënësit duhet të kenë më pak përgjegjësi sepse zaptohet e gjithë koha e tyre e lirë.
- Shtimi i lëndëve që mbulojnë Intuitën; Rëndësia e dashurisë dhe respektit; Ligji i tërheqjes; Për të gjitha mitet: se nuk ka mjaft, se mund të kemi sukses vetëm nëse punojmë shumë; Balancimi i

gjithçkaje në jetë; Shkuarja drejt qëllimit tuaj; Të qenit unike; Besime të kufizuara; Meditim; Ballafaqimi me depresionin; Të mos ndiqen pritjet e shoqërisë. Dhe të largohen lëndët që nuk janë të rëndësishme për dikë që nuk i ka zgjedhur profesionalisht.

- Të ndërtohen shkolla profesionale për profesione të tjera përveç atyre tashmë të ndërtuara, ku mësimet dhe lëndët do të përqendrohen në gjithçka që nevojitet vetëm për atë zonë.
- Për çdo secili profesion të ketë të paktën një herë në javë aktivitet që do t'i ndihmojë ata të zbatojnë profesionin në jetën reale (praktikë).
- Mësues miqësorë, por të ligjërojnë atë që duhet.

Për respektimin e mendimit të fëmijëve:

Trajnime për mësuesit ku ata japin mësim në lidhje me vlerësimin e mendimit të fëmijëve dhe të gjithë fëmijëve në mënyrë të barabartë; si të sillemi dhe të mësojmë fëmijët me aftësi të kufizuara; dhe ku do të mësohen se një 5-she nuk ia vlen për netët pa gjumë, për shëndetin. Se 5-shja nuk është mënyra e vetme që fëmijët të kenë sukses, që mos t'ju bëhet presion. Nëse mësuesit veprojnë në kundërshtim me atë që është dorëzuar, të dënohen.

- Të ndërtohet vetëbesim tek fëmijët dhe të shprehin mendimin e tyre nëpërmjet bisedave të hapura dhe takimeve joformale, si dhe nëpërmjet orëve ku do të ketë diskutim dhe nxënësit do të inkurajohen të shprehin mendimin e tyre, pa u notuar.

Për rolin e psikologut shkollor:

- Çdo shkollë duhet të ketë një psikolog cilësor, i cili do të ndihmon nxënësit, gjithmonë të sheh se diku ka nevojë për ndihmë, pa pritur që dikush t'u drejtohet atyre.
- Duhet të jetë e detyrueshme që çdo fëmijë të flasë me një psikolog të paktën një herë në muaj, në mënyrë që fëmijët të fitojnë besimin e psikologëve dhe më pas të shkojnë vetëm për të kërkuar ndihmë.
- Të normalizohet vizita te psikologu nëpërmjet diskutimeve në orën e kujdestarisë, takimeve joformale dhe disa leksioneve shtesë. Kjo duhet parë si diçka e zakonshme, jo diçka për t'u turpëruar.

Për edukimin dhe kujdesin për mjedisin jetësor:

- Përmirësimi i njohurive dhe kujdesit për mjedisin duke: mbjellë pemë të paktën katër herë në vit, pastruar oborrin e shkollës të paktën dy herë në vit, duke pasur një vit të tërë për të mbledhur plastike dhe bateri, të cilat do të ndiqen me një shpërblim, çdo shkollë të ketë një seksion ekologjikisht aktiv dhe më shpesh të ketë ligjërata dhe aksione për një mjedis më të mirë jetësor.

Për aktivitetet jashtëshkollore:

- Socializim, ndërtimi i ekipeve (team-building), antibulim ose kundër ngacmimit nga bashkëmoshatarët dhe si të ballafaqohen me të në shkolla.
- Të kemi një ditë në muaj ku fëmijët e shkollës do të kenë një takim joformal. Që takimi të ketë aktivitete të planifikuara ku fëmijët do të përzihen me njëri-tjetrin.

Për mësimdhënien në internet (online):

- Çdo fëmije që nuk do të jetë në gjendje vet të përballojë, të pajiset me gjithçka që i nevojitet nga teknologjia për të ndjekur orët në internet.

2. FËMIJË ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Kur bëhet fjalë për fëmijët me aftësi të kufizuara, të gjithë besojnë se ata janë të ndryshëm nga ne dhe se duhet të mësojnë në shkolla speciale, por ata janë fëmijë ashtu si ne. Hulumtimi tregoi se shkollat nuk kanë materialet dhe kushtet e nevojshme që ato të ndjekin dhe të jenë të pranishëm në mësimet pa ndonjë problem.

Kështu, 71.33% e fëmijëve thanë se nuk kanë rampa në shkolla ku mund të ngjiten fëmijët që duhet të lëvizin me ndihmën e një karrocë me rrota.

80.5% të nxënësve u përgjigjën se nuk ka asistent personal në shkollat e tyre. Gjithashtu, shumë shpesh disa prindër paguajnë të rritur që mund të ndihmojë fëmijën gjatë mësimëve. Por ka edhe shumë familje që nuk janë në gjendje të mirë financiare për të paguar dikë që të ulet me fëmijën e tyre. Kjo është arsyeja pse vetë shkollat duhet të kenë dikë që do të ndihmojë fëmijët me aftësi të kufizuara sepse kanë nevojë për ta.

Dhe më në fund, 82.57% të nxënësve u përgjigjën se shkollat e tyre nuk kanë siguruar libra shkollorë, kompjuterë ose teknologji tjetër me alfabetin Braj (Braille), alfabet i veçantë për personat me shikim të dëmtuar. Duke siguruar këto materiale, nxënësit me shikim të dobët do të jenë në gjendje ta ndjekin mësimet shumë më lehtë.

Rekomandim:

Shteti duhet të parasheh para për të siguruar ndihmës personal, rampa, alfabetin Braj dhe materiale tjera të nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara që më lehtë të marrin pjesë në mësimet.

3. MUNGESA E BURIMEVE NË DISA SHKOLLA

Që të kemi arsim të mirë dhe të suksesshëm duhet të kemi burime të mjaftueshme, por ato mungojnë në disa prej shkollave.

Një nga problemet më të mëdha është mungesa e librave shkollorë. Nxënësit marrin libra shkollorë të përdorur për pesë ose gjashtë gjenerata. Tavolinat dhe karriget e shkollës gjithashtu paraqesin problem të madh. Nxënësit ulen në karrige të thyera.

Në disa shkolla nuk ka qasje në kompjuter dhe teknologji, dhe në zonat rurale, shkollat nuk kanë palestra. Në disa shkolla nuk ka një oborr të rregullt të shkollës. Në disa nuk ka ngrohje, kështu që nxënësit ngrohen me ngrohës dhe soba.



Rekomandime:

- Të jepen libra të rinj për nxënësit, çdo vit.
- Çdo shkollë të sigurojë pajisje speciale për fëmijët me nevoja të veçanta, që ata të ndihen rehat në çdo pozicion.
- Të kemi më shumë burime për rekreacion të fëmijëve!
- Të ndërtohen palestra në shkollat ku nuk ka.
- Në shkolla, karriget dhe bankat duhet të rinovohen më shpesh (propozimi: çdo dy vjet).
- Të ketë ngrohje termike më të mirë!
- Të ketë qasje më të madhe në teknologji në shkolla!

4. HIGJIENA NË SHKOLLA

Higjiena është një nga gjërat më të rëndësishme, por nuk është në nivelin e dëshiruar në shkollat tona. Me hulumtimin kemi ardhur në këtë njohuri:

- 60.62% e fëmijëve pajtohen pjesërisht ose nuk pajtohen aspak që higjienës në shkollën e tyre i kushtohet vëmendja e mjaftueshme.
- 68,23% pajtohen plotësisht ose pjesërisht se tualetet në shkollën e tyre nuk janë të pastra dhe për këtë arsye shmangin përdorimin e tyre.
- 69.74% vetëm pjesërisht pajtohen ose nuk pajtohen fare që tualetet në shkollat e tyre janë të pastra dhe ka mjete për mirëmbajtjen e higjienës.

Rekomandime:

- Pastrim i rregullt i tualeteve.
- Punësim i më shumë pastruesve.
- Më shumë fonde për shkollat.
- Të ketë sapun dhe letër higjienike të mjaftueshme gjatë gjithë kohës.
- Të pastrohet uji atje ku nuk ka ujë të pijshëm.



TEMA 7

MJEDISI JETËSOR



TEMA 7: MJEDISI JETËSOR


Autore: Sara Duka dhe Erza Capa

Mjedisi ynë jetësor është rreth nesh, toka në të cilën jetojmë, ajri që thithim, uji që pimë, pemët që lëshojnë oksigjen dhe lulet me aromën e tyre. Për tu rritur të shëndetshëm, na duhen të gjitha këto, na duhet një mjedis i pastër jetësor sepse prej tij marrim të gjithë elementët e nevojshme për jetën.

Por, për fat të keq, mjedisi ynë jetësor gradualisht shkatërrohet dhe ne nuk përpiqemi ta mbrojmë atë, por përkundrazi, shpesh bëhemi shkak i ndotjes së tij duke hedhur mbeturina, duke prerë pyjet, duke ndotur ujin e pijshëm që na nevojitet.

Nga e gjithë kjo, ne fëmijët vuajmë më së shumti sepse jemi grupi më i ndjeshëm, me një organizëm në zhvillim. Duke thithur ajrin e ndotur dhe duke pirë ujë të ndotur, ne rrezikojmë të futim substanca të dëmshme në trup të cilat ndikojnë negativisht në rritjen dhe zhvillimin tonë.

Mjedisi jetësor përfaqëson vetë njeriun. Pasqyron jetën e njeriut si një libër i hapur. Nga momenti i lindjes deri në vdekje, njeriu është në kontakt të vazhdueshëm me mjedisin jetësor. Prej tij ne kemi marrë të gjitha gjërat që na duhen dhe ai është një pjesë integrale e jetës sonë. Problemi me ajrin e ndotur është një problem për shumicën e fëmijëve në vendin tonë. Në pyetjen drejtuar fëmijëve: "Si ndiheni kur ajri ndotet dhe si ndikon në jetën e përditshme" këto ishin disa nga përgjigjet e nxënësve:






Sa i përket problemeve të tjera, fëmijët shpesh shprehin pakënaqësi duke thënë se ajri dhe uji janë shumë të ndotur, përfshirë rrugët që shpesh janë plot me mbeturina.

Ne e dimë që gjërat nuk zgjidhen me një shkop magjik, por për çdo rast duhet të provojmë. 62.80% thonë se kanë marrë pjesë në aktivitete për mbrojtjen e mjedisit jetësor, ndërsa pjesa tjetër jo. Mbrojtja e mjedisit jetësor duhet të jetë pjesë integrale e çdo proces zhvillimi, dhe shkollat janë vendi ku edukimi mjedisor duhet të promovohet më shumë. Ne ju bëjmë thirrje me zë të lartë të gjithëve: “Të bashkohemi dhe të kontribuojmë për një mjedis të pastër jetësor dhe një jetë të shëndetshme.”


Rekomandime:

- Rritja e ndërgjegjësimit mjedisor tek popullata.
- Pyllëzimi dhe rregullimi i zonave të gjelbër.
- Menaxhimi adekuat i mbeturinave (përzgjedhja dhe riciklimi).
- Zvogëlimi i ndotjes industriale.





Erza Capa



Evgenija Xhabirska



Sara Abdushi



Erza Capa

Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë - Megjashi –
Republika e Maqedonisë
Rr. "Kosta Novakoviç" nr. 22a, 1000 Shkup
Tel. +389 2 2465 316
Posta elektronike: info@childrensembassy.org.mk
Ueb-faqja: www.childrensembassy.org.mk